

Dr. Mithat Aydin
Dr. Mehmet Tütüncü
Dr. Ardian Muhaj

MBI QËNDRIMIN E QEVERISË OSMANE NDAJ SHPALLJES SË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Paraqitje

Dokumenti i mëposhtëm është nga arkivat osmane dhe mban datën 27 nëntor 1912. Është një vendim i kabinetit qeveritar osman i nënshkruar nga anëtarët e këtij kabineti. Dokumenti është një përgjigje e qartë mbi disa sqarime të kërkuara nga komandanti osman i zonës së Shqipërisë së Jugut dhe Çamërisë me qendër në Janinë, pra nga kryekomandanti i vilajetit të Janinës, Esat pashë Janina. Ai kërkon nga qeveria e Stambollit një udhëzim se çfarë duhet të bëjë me Ismail Qemalin dhe bashkëpunëtorët e tij, të cilët kishin lënë Durrësin dhe pritëshin nga çasti në çast të mbërrinin në Vlorë për të mbajtur një kuvend mbi çështjen e Shqipërisë. Përgjigjja e Stambollit zyrtar është e qartë dhe e prerë që të mos pengohej në asnjë mënyrë mbajtja e atij kuvendi, pasi Ismail Qemali kishte tashmë aprovimin e qeverisë osmane për të organizuar një kuvend shqiptar, ku të shpallej autonomia më e lartë e krejt Shqipërisë, me përjashtim të shkëputjes nga shteti osman. Siç dihet, më 28 nëntor 1912, delegatët e mbledhur nga të gjitha trojet shqiptare që kishin mundur të mbërrinin në Vlorë, u pajtuan njëzëri pas diskutimesh të shumta që të shpallej jo autonomia e plotë, por pavarësia e plotë e Shqipërisë nga shteti osman. Parë në këtë aspekt, me gjithë rëndësinë që ka mbështetja e qeverisë osmane për mbajtjen e kuvendit dhe aprovimi nga ana e saj e kërkesës së pritshme për autonomi të lartë e krejt Shqipërisë, vendimi i delegatëve të kuvendit ishte një akt madhor përgjegjësie dhe zgjuarsie politike. Delegatët shqiptarë të mbledhur në Kuvendin e Vlorës ishin shumë më në dijeni të situatës dhe natyrisht zëdhënës të vërtetë të aspiratës

së shqiptarëve për krijimin e shtetit kombëtar, sikurse të gjitha kombet e tjera ballkanike.

Transkriptimi

MV. +171, 53,

İsmail Kemal Bey ile arkadaşları ve birkaç yabancının Avlonya'da Arnavutluk siyasî meselesi hakkında yapacakları kongreye engel olunmamasının mahalli kumandanlığa tebliği.
H-17-Zilh-1330

1. Hülâsa Meali
2. Yanya Kolordu kumandanlığından alınan şifre telgrafname suretinin gönderildiğine ve bazı ifadata dair Harbiye Nezareti Vekaletinin tezkiresi ve melfufu
3. okundu
4. (Meclis-i Vükela) Kararı
5. Mezkur telgrafnamede İsmail Kemal Bey'in 14 refiki ve birkaç ecnebi ile Draç'a muvâsalatla Arnavutluk mes'ele-i siyasiyesi temin
6. edildiğinden bahsle mülhakâtdan Avlonya'ya murahhaslar da'vet eylediği ve kendisi de Avlonya'ya müteheyhin 'azimet bulunduğu ve oradaki idâre-i örfiye
7. münasebetiyle her nev'i içtimâ'âta memnuniyetine nazaran tertib edecekleri kongrenin 'adem-I icrası lüzûmunun icâb edenlere tebliği ve ısrar edecek
8. oldukları halde idâre-i 'örfiye kararnamesinin tatbiki cânib-i vilâyetden mülhakâta tamîmen bildirildiği ve mîr-i mumaileyhin Dersâ'âdetden 'avdet etmiş
9. olması cihetiyle teşebbüsâtdan Hükümet-i Seniyyenin de haberdar olması tabii bulunduğu dermeyan olunmuşdur.
10. Bütün Arnavutluk'un tefrik kabul etmemek üzere idâre-i mümtâze şeklinde bulundurulması devletçe de müstelzem olduğundan İsmail Kemal Bey'in
11. fikri de bu merkezde bulunduğu lede'l-tedkik anlaşıldığı halde teşebbüsât-ı vakı'aya mümâna'at olunmaması lüzumunun mezkur kumandanlığa lace't-tebliğ
12. Harbiye Nezâreti Vekâletine iş'ârı ve Dâhiliye Nezaretine malûmât i'tâsı tezkire kılındı.

Përkthimi në shqip

Këshilli i Ministrave - Mescidi Vukela

27 nëntor 1912

Komandanti i Janinës ka dërguar një telegraf të koduar dhe ka shtruar disa pyetje për qeverinë. Ismail Qemali me 14 bashkëpunëtorë dhe disa nënshtetas të huaj do të mbajë një kuvend mbi situatën politike në Shqipëri. Është me shumë rëndësi që të mos pengohet mbajtja e këtij kuvendi. Në telegrafin e përmendur më herët thuhet se Ismail Qemali me 14 bashkëpunëtorë të tij dhe disa nënshtetas të huaj ka mbërritur në Durrës me qëllim për të mbërritur në një zgjidhje politike për çështjen shqiptare. Për këtë ai ka thirrur mbledhjen e delegatëve në Vlorë, dhe ai vetë do mbërrijë së shpejti në Vlorë për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme atje. Ai kërkon të mund të organizojë një kuvend në këtë situatë emergjente. Ky kuvend është i një rëndësie tepër të madhe. Për arsye se ai sapo ka mbërritur nga kryeqyteti, ai dëshiron të informojë qeverinë sulltanore dhe kërkon leje për mbajtjen e këtij kuvendi. Në fakt është qëndrimi i qeverisë sonë për t'i akorduar autonominë më të lartë të gjitha territoreve shqiptare me përjashtim të shkëputjes. Për më tepër, pas shqyrtimeve tona dimë se ky është edhe qëllimi i këtij kuvendi dhe për këtë arsye është me shumë rëndësi që të mos pengohet mbajtja e tij. Nga ana jonë do të vëmë në dijeni komandantin e sipërpërmendur si edhe Ministrinë e Luftës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi këtë çështje. MV., 171/53, 17.12.1330 (27 nëntor 1912).

